

VENDIM
Nr. 542, datë 18.6.2015

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA TIRANË,
PËR SHOQËRINË “UJËSJELLËS - KANALIZIME”, SHA, TIRANË, TË NJË
SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, PREJ 3 270.41 M², BRENDË TERRITORIT TË
PRONËS ME NR. 133, ME EMËRTIM “SHTABI I REPARTIT USHTARAK NR. 8836”,
ME VENDNDODHJE NË YZBERISHT, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 2, 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, për shoqërinë “Ujësjellës - Kanalizime”, sh.a., Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional, prej 3 270.41 (tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë dyzet e një) m², brenda territorit të pronës me nr. 133, me emërtim “Shtabi i Repartit Ushtarak nr. 8836”, me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një depoje uji, për furnizimin me ujë të zonës në Unazën e Re, Yzberisht dhe në fushën “Misto Mame”, Tiranë.

2. Sipërfaqja e truallit funksional, prej 3 270.41 (tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë pikë dyzet e një) m², pjesë e pronës me nr. 133, me emërtim “Shtabi i Repartit Ushtarak nr. 8836”, me vendndodhje në Yzberisht, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme të sistemeve të ujësjellës - kanalizimeve, për shoqërinë “Ujësjellës - Kanalizime”, sh.a., të Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë dhe “Ujësjellës – Kana-lizimeve” sh.a., Tiranë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së truallit funksional të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë apo t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministri i Transportit dhe Infra-strukturës, Bashkia Tiranë, “Ujësjellës – Kana-lizime”, sh.a., Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**Plan Vendasja e (Pronës nr.133)
Rep. Usht. nr. 8836 A.K.A, Yzberisht, Tiranë**

(Sip. që kërkohet për transferim nga MM, Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime SH.A, Tiranë)

Sistemi i koordinatave Shqiptare



Punoi
Ing. Albert Murati

Shkalla 1:1000

Përgj. Sek. Ramiz HAXHIU



